

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Rikthehen temperaturat e larta, parashikimi i motit gjatë javës - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/rikthehen-temperaturat-e-larta-parashikimi-i-motit-gjate-javes/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 09:23:02 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 09:15:40 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	213fa2046447ad6476e95238a6635e6e388697dbc0c938f8ee09397736cfe64b
TEKSTI	4d43b336bd98d5a1e485feff7fe966e4c014be1029d25edd6863a2a9d8172a4a
PAMJA	d9146de3aa7e029705c82da2ba95180f460b8d2799bbb1c459ca938fcacf8650d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f1253c4d15f53b3ab0e555a94d54c89920f7cd1025dfc33b774a87d790d0091d
E MËPARSHMJA	—
RRËNJJA MERKLE	b28949f398f9c40f36f567d35f036ed2a879d9ccf77f144b0ee032f95e15789d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/f1253c4d15f53b3ab0e555a94d54c89920f7cd1025dfc33b774a87d790d0091d>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.


Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

SHBA Edi Rama BE Pagat e gjyqtarëve Këshilli i Sigurisë Kombëtare

AKTUALITET | EURONEWS NOW ME ESMERALDA MULAJ

Rikthehen temperaturat e larta, parashikimi i motit gjatë javës



28 Shtator 2026 | 11:15

Në një lidhje live për Euronews, meteorologu Hakil Osmani bëri parashikimin e motit për këtë javë. Sipas tij, në ditët në vijim, edhe pse jemi në vjeshtë, do të kemi temperatura të larta dhe ditë të gjata me diell.

Sakaq, ai theksoi se orët e para të mëngjesit do të jenë kryesisht të freskëta, ndërsa ditën e mërkurë dhe të enjten pritet të dominojnë intervalet e gjata me kthjellime dhe temperatura të larta. Ndërsa, pjesa e dytë e javës pritet të shoqërohet me vranësira disi më të shpeshta.

“Kjo javë parashikohet të jetë nën mbizotërimin e motit të qëndrueshëm, duke bërë që të kemi intervale të gjata me diell. Më të dukshme do të jenë gjatë orëve të para të mëngjesit edhe mesditës, kryesisht në vijën bregdetare dhe qytetet e zonës së ulët. Ndërsa në zonat malore, gjatë orëve të pasdites herë pas here do të ketë kalime të lehta të vranësirave.

Pjesa e parë e javës, pra deri ditën e mërkurë e ditën e enjte, pritet që kryesisht të kemi dominim të intervaleve të gjata me kthjellime, ndërsa pjesa e dytë e javës pritet t'i ketë vranësirat disi më të shpeshta, duke bërë që përgjatë fundjavës, kryesisht dita e diel, herë pas here në zona të izoluar në shtrirjen lindore të kemi vetëm momente të pakta me pika shiu. Ndërsa pjesa tjetër e territorit do të jetë nën mbizotërimin e motit të qëndrueshëm.

Intervalet e gjata me diell do të bëjnë që në orët e mesditës të kemi dhe rritje të temperaturave të ajrit, duke bërë që deri ditën e mërkurë territori shqiptar maksimalisht të kapë vlerën 30 apo 31 °C në qytetet e zonës së ulët dhe në një pjesë të mirë të vijës bregdetare. Ndërsa në zonat malore maksimumet do të jenë rreth vlerës 23 apo 24 °C.

Duke filluar nga dita e enjte e në vijim, në orët e mesditës do të kemi dhe një rënie graduale të temperaturave të ajrit, duke bërë që maksimumet të jenë rreth vlerës 28 apo 27 °C. Janë temperatura rreth 3 gradë më të larta se vlera normale për sa i përket fillimit të tetorit.

Nëse flasim pastaj për orët e para të mëngjesit, minimumet janë regjistruar në 8 °C mëngjesin e sotëm në qytetet e zonës malore, ndërsa në ultësirën perëndimore kanë luhatur nga 12 pranë vlerave 15-16 °C në vijën bregdetare. Duke filluar nga dita e martë, të paktën deri në mëngjesin e ditës së enjte, pritet që temperaturat e ajrit të kenë një rritje të lehtë graduale, duke bërë që ato të jenë rreth vlerës 10 °C në qytetet e zonës malore, ndërsa në ultësirën perëndimore të luhaten nga 14 e deri në 17 °C në vijën bregdetare”, u shpre Osmani.

LAJMI I FUNDIT

11:07 Rama i drejtohet: Mos e lini në baltë Ballkanin

11:03 Protestat në Madrid hyjnë në ditën e tretë pas debimit të pensionistes

11:02 Hamasi sulmon Ben-Gvirin pas kërcënimit për të vvarë të burgosurin palestinez

SHPEËRDAJE
ARTIKULLIN
Fuçiq i dorëzon detyrën Ana Brnabić, kryetarja e Kuvendit merr përkohësisht drejtimin e Presidencës së Serbisë

10:51 BE -ja harton plan veprimi për kandidatët premtues, mes tyre dhe Shqipëria

10:50 Ronaldo u la në stol, Portugalia fiton 2-1 ndaj Norvegjisë

TESTIM

Shiko në:

LAJME TË SUGJERUARA

AKTUALITET | VENDI

Reforma territoriale, Këshilli Bashkiak i Maliqit voton kundër “shkrirjes” me Korçën

Këshilli Bashkiak i Maliqit është mbledhur ditën e sotme për të diskutuar dhe më pas për të votuar projektvendimin për draftin e Reformës Territoriale. Mbledhja...

10:16 | 28/09/2026

AKTUALITET | VENDI

Mbyllet mbledhja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare

Këshilli i Sigurisë Kombëtare, i thirrur nga Presidenti Bajram Begaj, ka përfunduar mbledhjen e zhvilluar këtë të hënë në Pallatin e Brigadave. Takimi nisi në...

10:08 | 28/09/2026

AKTUALITET | VENDI

Zhvillohen tre operacione në Tropojë e Kukës, arrestohen 3 persona për armëmbajtje, kultivim të narkotikëve dhe vjedhje

Tre persona janë vënë në pranga këtë të hënë, pas tre operacioneve të ndryshme të zhvilluara në Tropojë dhe Kukës, pasi akuzohen për veprat penale...

10:06 | 28/09/2026

TEMA	SHËRBIME	KOMPANIA
Vendi	Live	Rreth Euronews
Rajoni	Lajmi fundit	Kushtet e përdorimit
Bota	Na ndiqni	Politika e cookie
Video	Euronews Radio	Kontaktoni
	Për persona me aftësi të kufizuara	Punësimi

Follow Euronews on all platforms: